



Npi – 01/79 datë: 24.02.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 24.02.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T **P R O C E S V E R B A L**

I Mbledhjes së -II- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 24.02.2025 (e hënë), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu; Të gjithë drejtorët e drejtorive komunale; Shefja e Kabinetit të Kryetarit, znj.Anita Kurti; Nga zyra për të drejtat e Njeriut dhe Barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni; Zyrtarë i IT-së, z.Shpëtim Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.01.2025,
2. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, (Pas diskutimit publik)
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur,
5. Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristo-bancor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime,
6. Informatë e DBF-së për Raportin Periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.
7. Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes,
8. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Në Planin e punës e kemi të paraparë si pikë të rendit të ditës për këtë muaj edhe pikën "Informatë nga DKA për përfundimin e gjysëm-vjetorit të parë shkollor 2024/25", kjo pikë nuk ka ardhur cila është arsyeja?

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Sa i përket pikave të rendit të ditës unë propozoj që pika e 5 e rendit të ditës "Propozim-Venmim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristobanesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime" të hiqet nga rendi i ditës. Unë e kam dhënë arsyen edhe në KPF-se, është interes i qytetarëve, kështu që një numër i mirë i banorëve të objektit nuk janë mirë të informuar, prandaj edhe propozoj që kjo pikë me u shty dhe me bërë një thirrje publike, për secilin qytetarë që të jetë i informuar. Unë konsideroj se nuk ka nevojë shumë debat për këtë propozim timin.

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Sa i përket pikës së 5 që e propozoi parafolsi, edhe ne e përkrahim jo me idenë e refuzimit por me idenë që të kemi informata të sakta, duhet që në Kuvend të sillen evidencat e pronarëve, qytetarët duhet ta dinë këtë çështje, kështu që duhet të dihet se kujt do ti kompenzohet, pronarit që e ka ble pronën, apo do ti kompenzohet atij që e ka në emër të tijë.

z.Rrahman Jakupi: Zonja dhe zotërinjë, të nderum qytetarë të komunës së Shtimes. Duke u bazu në Ligjin për Vetëqeverisje Lokle dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve para jush po propozoj një pikë shtesë të rendit të ditës, meqë u propozu me u hjekë një, unë propozoj me u shtu një, është kërkesë e banorëve të fshatit Rashincë për të cilën po e lexoj pjesën për të cilën kanë kërkuar që të jetë pië e rendit të ditës (në vazhdim lexoi një shkresë) pra pikë shtesë e propozuar është diskutimi për çështjen apo rishqyrtimi i çështjes të ujësllësit në fshatin Rashincë. Ndërsa sa i përket pikës tjetër të rendit të ditës unë pajtohem që pika të shtyhet për mbledhjen e radhës, me arsyetimin se dokumenti që është sjellë nuk e përmbanë pjesën arsyetuese, dhe ne nuk kemi informacione, kështu që ky dokument është i mangët.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. U dhanë arsyetime të shumta lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës që të shtyhet kjo pikë. Edhe ne realisht po pajtohem me disa parafolës. Me sa e di unë ka pas një dëgjim publik më 12.02.2025 në të cilin kanë pasë mundësi të gjithë qytetarët e komunës së Shtimes të marrin pjesë dhe të shprehin mendimet ose kërkesat e tyre. Jamë që të kërkojnë sçarime edhe më të detajzume, për të cilat edhe ne si grup parlamentar do të jemi "pro" shtyrjes së kësaj pike. Duhet me di se projekti është shumë i rëndësishëm për qytetarët për të cilin edhe është ndarë buxheti dhe e kemi fazën e realizimit veq se me marrjen e këtij vendimi e që uroj nëse jo në këtë seancë në tjetrën seancë ta merr aprovimin e gjithë këshilltarëve komunal.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. Në këtë mbledhje e kemi një rend të ditës të cilin na e keni sjellë edhe materialin, mendoj se jemi në parim për këto pika të rendit të ditës. Patë kritika se nuk janë disa pika në përputhje me planin e punës, po pajtoj por mbi të gjitha nuk mund të jenë të gjitha pikat e rendit të ditës ashtu siç kemi planifikuar. Sa i përket propozimit për pikën e 5 ishin disa kërkesa për ta shty por unë mendoj mbi të gjitha se ishin kërkesa të pozitës, opozita e përkrahu me arsyetim të kompletimit të dokumentacionit, jo te dëgjimet publike. Kam njohuri se dëgjimi publik është bërë duke e arsyetuar me një procesverbal ku shihet se kanë marrë pjesë 43 pjesëmarrës, nënshkrime nuk kemi, po kan diskutuar nja 4-5 prej tyre. Duke e parë rrezikun nga kjo ndërtesë të gjendjes së sajë faktike, unë mendoj se çdo vonesë jemi te shkalla e rrezikut të banorëve. Objekti është i ndërtuar para lufte dhe nuk e dimë me far materiali, pastaj duke i pa neper Kosovë që objektet e vjetra po paraqesin shkallë të rrezikut për banorët ku ka edhe të atyre me fatalitet, nëse ndodhë ajo kush e ka përgjegjësinë, sepse ne vet po i zvarrisim gjërat. Çdo gjë që është në interes të qytetarit ne duhet ta përkrahim, sepse disa projekte po na hupin edhe hapin. Nëse zotohet drejtori që të na sjell materialin e 34 njërive banesore, pse mos ta kalojmë. Në emër të LB-së unë kërkoj një kompletim të dokumentacionit për 34 njësit banesore me emër e mbiemër.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Pajtoj me rendin e ditës, po ashtu pajtoj me propozimin për me u shty pika e 5 e rendit të ditës. Faktikisht ne me material jemi mangu, për këtë arsye unë jamë për me shty këtë pikë. Në material keni thënë se bashkëngjitur keni çertifikatën e njërive

banesore unë Certifikatë nuk kamë, nuk i kemi pronarët kush janë ata, cilët janë legjitim, ndoshta ka pronarë që e kanë ble dhe nuk e kanë në pronësi, kështu që këtu në Kuvend duhet me u bë këto eliminime të paqartësive prandaj po pajtoj që kjo pikë të shtyhet.

z.Kadri Emini: Vetëm desha me qartësu propozimin që u dha nga Rrahman Jakupi lidhur me çështjen e Rashincës, meqenëse e kemi drejtorin e DSHP-së që është mirë me dhënë një arsyetim, sepse i njëjti problem besoj se është sanuar, kështu që nëse është sanuar, mendoj se është e panevojshme me e diskutuar.

z.Rrahman Jakupi: Sa për sçarim, kërkesa nuk ishte për defektin por ishte për komplet sistemin e ujësjellësit në fshatin Rashinc. Ka qenë edhe kërkesë e mëparshme.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Sinqerisht këtë diskutim kam dasht me bërë kur kishim arritur te kjo pikë. Ne si komunë e Shtimes e kemi realizuar një dëgjim publik më 12.02.2025 me pronarët të cilët janë me fleta poseduese, është e vërtetë që mundet me pas pronarë tjetër jashtë fletave poseduese, prandaj edhe kjo është arsyeja se pse ne nuk i kemi dorëzuar te ju fletat poseduese. Kush është i interesuar prej anëtarëve të Kuvendit secili mundet me ardhë edhe me i pa këto sepse unë i kamë këtu përpara. Arsyeja e dëgjimit është me ju tregu qytetarëve se po fillon një process i shpronësimit në këtë objekt, edhe e kenë një kohë 3-4 muaj për me rregullu dokumentacionin. Pagesa bëhet me numër të fletës poseduese jo në emër të pronarit, dhe për këtë arsye ne nuk kemi bërë listë të emrave të pronarëve. Të gjitha procedurat ligjore janë në rregull për këtë objekt, dhe të gjithë po pajtohemi që ky objekt duhet me u rrënuar. Çështja e vendimit i takon Kuvendit. Ne si drejtori jemi të përgatitur që secilit qytetarë me i dhënë përgjigje për sa i takon këtij objekti.

z.Përparim Ramusa: Drejtor faleminderit për një sçarim gjysmak që na e dhe. Sa po kuptoj unë këtu është edhe pozita që bashkpunoni ju në qeverisje është e pa kënaqur me punën e juaj, sikurse që jemi të pa kënaqur edhe na. Nuk kanë me votu qytetarët por ne Kuvendarët. Është një pjesë e madhe e mjeteve, smujmë na me votu në mënyrë paushalle, që të ishte mirë e marë ne u dashtë me i pas të gjitha dosjet e pronarëve para 7 dite. Sa kanë prona shqiptarët aty, sa kanë prona serbët, sa kanë komunitetet tjera. Kështu që është ide e mirë që edhe ne po e përkrahim për me u shty deri në mbledhjen e radhës, deri isha ju të na paisni me informata shtesë.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Përshëndetje. Edhe unë e kamë pa në veb-faqen e fshatit Rashinc, që ka qenë një prishje por ajo prishje është sanuar. Por ka qenë edhe diçka që është thane që rrjeti do të vazhdon deri në Godanc, e që nuk është e vërtetë. Është një gyp në rrjetin ekzistues nga l cili bëhet furnizimi në fshatin Gjyrkovc te shtëpijat e para që nuk kanë ujësjellës në atë pjesë sepse fshati Gjyrkovc si fshat ka mirëpo janë vetëm disa shtëpija që nuk kanë, por jo rrjeti me ardhur në Godanc. Ky pra është sçarimi, nëse ka pyetje këtu jemi për përgjigje.

z.Rexhep Gashi: Drejtor mendoj se duhet të jemi pak më konkret. Unë qysh në fillim i dhash vërejtjet. Nuk mundemi me fol sepse e kemi një përgjegjësi edhe na edhe ju, arsyeja është e thjeshtë se kur themi, gypa nuk ka, këta kanë kërkuar të formohet një komision banorët e fshatit Rashinc, unë kaloj 5 herë kaha ta gypa dhe gypa ka mbitoksor te guri beton janë mbi tokë, e marr me përgjegjësi të plotë, kanë kërkuar komision qytetarët jo unë, kemi marrë vota aty. Pse bash te Guri Beton gyp i po e kalon asfaltin, cilat shtëpija të Gjyrkovcit të para janë, ato janë nga Muzeqina, nga Gracka, nga Davidovci nga Bujani, varet tik aty i merr të parat e që duhet me u cek. Ka emërtime të rrugëve duhet të jemi të sakt. Kryetari është zotuar se do të ketë ujësjellës cep më cep por nuk kemi ujë në Gjyrkovc në kohën e verës deri në Shtator varsisht nga reshjet.

z.Besnik Seferi: Shum shkurt Kryesues, nuk dashta me hy në këtë pikë, edhe pse nuk është se nuk është me interes e mos të keqkuptohem nga banorët e fshatit Rashinc, por jëmend është bërë e diskutueshme kjo pjesë duke u lidhë te çështja e ujësjellësit. Duhet me ditë përspektivën që e ka ky projekt dhe vlerën e madhe që ka për tu investu. E dyta edhe unë personalisht nuk jam kundër që të diskutohet kjo pikë. Por ytu pas parasysh që kemi një pikë pyetje-përgjigje, mendoj se është mundësia më e mirë që të marrim përgjigje, por jo ta qesim si pikë të rendit të ditës.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoresh e DKA: Përshëndetje. E falënderoj Rrezën për pyetjen. Ideja është që unë në muajin Shtator e kamë dhënë një informatë, pastaj e kam pas prap një informatë

në muajin Shkurt, edhe një informatë tjetër e kamë në muajin Qershor, kështu që po i bie se po i jap 3 informata gjatë kësaj kohe, gjë që mu ka duk pak e pa arsyeshme dhe e kam pa të rrugës që me e përmbledhë diskutimin për informatën që e kamë në muajin Shkurt me e bërë një përmbledhje të informatës komplet në muajin Qershor, kjo ka qenë arsyeja.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Kryesues të kisha sygjerruar që pikat e rendit të ditës të mos diskutohen në këtë mënyrë ende pa u miratuar rendi i ditës, sepse shumë po zgjaten, u bë një orë që ka filluar seanca dhe ne ende nuk e kemi miratuar rendin e ditës. Te çështja e ujësjellësit drejtori e shpatoi shumë mirë. Nuk duhet tash të diskutojmë dhe ta bëjmë ujësjellësin çështje politike, sepse deri tash rrjeti i ujësjellësit u kanë dashtë me u kry në krejt fashatrat e komunës dhe në gjithë qytetin e Shtimes, e jo prap në 2025 me u diskutu për këto probleme, edhe jo vetëm që diskutohet por po mundohen me ba pengesa vazhdimisht që problem me zgjatë sa më shumë. Këta as nuk e kanë zgjedhë këtë problem, dhe ende tu kqyr me ba pengesa, prandaj Kryesues këso diskutime mos lejo me u bë pa u miratuar rendi i ditës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Po pajtohem plotësisht me zotëri Beqën që duhet të vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës dhe pastaj të diskutohet sipas pikave. E pash që të gjithë shefat e grupeve parlamentare janë të pajtimit që të shtyhet pika e 5 e rendit të ditës edhe përkundër shqarimeve që i dha drejtori, vetëm që duhet me e kuptu se kjo pikë është shumë e rëndësishme për qytetarët edhe për neve gjithsesi. U tha se Shtimes i humbin 3 milion euro, duhet ta dini se ky projekt nuk është i buxhetuar me buxhetin e Komunës së Shtimes por janë nga niveli Qendror për fillimin e punimeve, dhe mbase mund të jetë edhe buxhet më i madh. Po pajtohem me zotri Gashin kur thot për rrezikshmërinë e objektit sepse të gjithë e dimë se në far gjendje është. Për çështjet tjera teknike e ligjore duhet me pas parasysh faktin se është edhe Gjykata. Unë nuk besoj që dikush duhet mi pas gjithë dokumentat e pronarëve që janë. Ju e dini se fletën poseduese nuk mund ta ketë askush përveç pronarit. Kështu që edhe unë po propozoj që ta hudhi në votim rendin e ditës me kërkesën e Kadri Eminit që të shtyhet pika e 5 e rendit të ditës, dhe kërkoj edhe një herë nga drejtoria që këto informacione që u kërkuan nga anëtarët e Kuvendit që ti sillni në seancën e radhës dhe ta votojmë këtë pikë që është shumë e rëndësishme.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi rendin e ditës pa pikën e 5 të rendit të ditës "Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm objektin afaristobanesor përballë Komunës me komplet njësitë e sajë, dhe me ngastrën kadastrale Nr.P-01667-1, Z.K-Shtime" si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.01.2025,
2. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, (Pas diskutimit publik)
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur,
5. Informatë e DBF-së për Raportin Periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.
6. Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuetisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes,
7. Pyetje – Përgjigje.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.01.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rahman Jakupi: Një pikë u hjek por unë propozova që me u futë një pikë tjetër shtesë sipas LVL-së, kush po ta jep të drejtën me ma hjekë propozimin për votim. A ka këtu ndonjë zyrtarë ligjor apo janë vetëm për me marrë paga. Kjo nuk shkon kështu qysh po mendon ti.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Unë punoj në bazë të Rregullores. Rregullorja thotë që të qitet në votim propozimi i parë, ku për këtë propozim edhe shëfat e grupeve parlamentare u pajtuan të gjithë, dhe unë e qita në votim, edhe u votua unanimisht, në momentin që qitet në votim propozimi i parë në këtë rast i Kadri Eminit, edhe sikurse u pa rendi i ditës u votua unanimisht nga të gjithë duke marrë parasysh propozimin që të hiqet pika e 5 nga rendi i ditës. Nuk ka mundësi me qit propozime të tjera në votim.

z.Përparim Ramusa: Për procesverbal nuk kam mirpo një shënim po e jap për qytetarë, kërkesa ka qenë e banorëve të fshatit Rashincë, dhe propozimi ishte të futet si pikë shtesë dhe ti e ke shkel rregulloren se nuk e ke hdukë në votim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Në momentin që kalon propozimi i parë nuk qiten në votim propozime tjera, kështu e thotë rregullorja.

z.Rahman Jakupi: Unë jam në kordinim edhe me të tjerët. Rregullorja është më e vogël se sa Ligji (Në vazhdim lexoi nenin 47.2 të LVL-së).

z.Besnik Seferi: Edhe ne dimë që ta lexojmë ligjin dhe Rregulloret (Në vazhdim lexoi nenin 6.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit).

z.Rahman Jakupi: Ju nuk mundeni me paragjyku, a jeni ju zyrtar ligjor.

znj.Albana Podvorica: Përshëndetje. Në procesverbalin e mbledhje së kaluar konkretisht te pika e 9 kërkoj nga sekretaria që të largohet një pjesë ku është deviju fjalimi im që thuhet "keqtrajtimi i një të riut" kërkoj që vetëm kjo pjesë të largohet sepse unë nuk e kam folë këtë fjalë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstënim" miratoi Ekstrakt-Procesverbalin e Kuvendit nga mbledhja e mbajtur më 27.01.2025.

Pika 2

Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ja jap drejtorit Bardhyl Rushitit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Përshëndetje. Bazuar në vendimin e Kuvendit, ne e kemi nxjerrë në diskutim publik, Draft-Planin Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Diskutimin me qytetarë e kemi mbajtur më datën 11.02.2025 në ora 14:00h në sallën e Kuvendit. Propozime konkrete nga qytetarët nuk kishte përveç diskutimeve të cilat qëllimin kryesor e kishin Implementimin e këtij plani, me qëllim që ta kemi një ambient më të pastër. Deponia që planifikohet të ndërtohet sipas këtij plani do të jetë diku në mes të Gjilanit dhe Ferizajt. Meqenëse materialin e kemi marrë me kohë, unë nuk do ta zgjati shumë, sepse është një material shumë voluminoz ku pjesa e parë është Planin Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave, dhe pjesa e dytë është, Vlerësimi strategjik i planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Nëse keni ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ti miratoni.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. Ne e kemi marrë materialin që është një material mjaft voluminoz, dhe e përkrahim. Është një plan shumë i mirë që është bërë një punë e madhe për të cilin i falënderojmë GIZ-in Gjerman por edhe të gjithë të tjerët që kanë punuar për ta hartuar këtë plan. Planin është në të mirën e qytetarëve por edhe në të mirë të mbrojtjes së ambientit ku përfshihen shumë komuna në rexhionin Gjilan-Ferizaj. Normalisht që ne si grup parlamentar LDK-AKR do ta përkrahim dhe urojmë implementimin e tij sa më parë.

znj. Adelina Beqaj: Përshëndetje. Këtë plan e kemi diskutuar edhe në KPF-ë dhe ne e poërkrahim këtë Plan. Drejtori që vjen nga fshati Rashincë kaq rëndësi të madhe i jep kësaj e nuk i jep rëndësi ujësjellësit të fshatit prej nga vjen.

z. Kadri Emini: Një sçarim, ne këtu po flasim për një Draft- Plan ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, dhe e thae se nuk ka ndonjë propozim për ndryshimin e këtijë draft-plani, pyetja ime është a ka ndonjë ndryshim të propozuar nga drejtoritë komunale?

z. Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Jo nuk ka asnjë ndryshim të propozuar as nga ana e drejtorive komunale.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi Komunës së Shtimes, me 18 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstënim" miratoi Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin Gjilan-Ferizaj, si dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planeve Ndërkomunale.

Pika 3

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera FN&FT për Janar-Dhjetor 2024

Kryesuesi, z. Adnan Ademi: Për këtë pike fjalën ja dha drejtorit Bardhyl Rushitit.

z. Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Këtë raport e ka bërë Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi tjera të ndodhura gjatë vitit 2024. Raporti është miratuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Sivjet për herën e parë po kërkohet që ky raport me kalu dhe me u miratu edhe në Kuvendet Komunale. E pas miratimit me vendim të Kuvendit me shku për pagesë në nivelin qendror. Nga KPF-ja kemi kërkesën për ti sçaruar edhe 14 kërkesat tjera që janë refuzuar nga Komisioni. Materialin e keni marrë me kohë e unë do ta lexoj shkurtimisht, për arsyet e refuzimit të tyre. (Shih Dokumentin) Nëse ka ndonjë pyetje unë këtu jam për tu përgjigjur. Ju ftoj që ta miratoni.

znj. Adelina Beqaj: Nuk po më duket fort i arsyeshëm arsyetimi i juaj, sepse unë e di që ka kërkesa nga viti 2023 e të cilat nuk janë kompenzuar. Prandaj unë e kamë këtë pyetje për drejtorin se sa janë gjasat që me u kompenzuar të gjithë ata të cilët kanë pas dëme gjatë vitit 2023-24?

znj. Albana Podvorica: Ne e kemi një raport, por po e lus drejtorin nëse kemi mundësi ne me pas një raport narrativ se kush është kompenzuar e kush jo për sa u përket dëmeve në bujqësi dhe dëmet tjera? Kjo pra përveq të tjerave e kishte rritë edhe transparencën.

z. Muhamet Ademaj: E falënderoj drejtorin për punën e bërë në hartimin e këtijë raporti mbi vlerësimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Komuna duhet të reagojë pa vonesë në raste të fatkeqësive natyrore. Kjo është thelbësore për ti mbrojtur qytetarët, nevoja për marrjen e masave në infrastrukturë për minimizimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.

znj. Rrezartë Ramadani: Te lista e dëmeve në bujqësi është një person që përmendet dy herë në këtë listë, po më intereson arsyeja pse po përmendet dy herë? A është gabim teknik apo ka arsye tjetër. Ky është edhe te numri rendor 13 edhe te numri rendor 16.

z. Përparim Ramusa: Fillimisht dua me repliku me drejtorin që tha nuk po dua me i bë publik emrat e atyre që ua kemi refuzuar kërkesat për çështjen e privatësis, neve na e ke dërguar një listë të personave që u është vlerësuar dëmi me emër mbiemër e nr. të letërnjoftimit, e tash pse ne nuk mund ta kemi listën e atyre personave që janë refuzuar. E falënderoj Komisionin që e ka bërë këtë punë për një vlerësim real dhe korrekt. Pyetje për ju drejtor çka ka ndodhë me fermeret që u ka bërë dëmi në vitin 2021 pse nuk i keni paguar dikund vlera është 18.000 euro. Çka ka ndodhur me 40 fermer te dëmtuar në vitin 2023 vlera e dëmeve ka qenë 34,814 euro jane refuzuar se nuk keni dit me apliku dhe neglizhenc e juaja. Ne si grup parlamentar e votojmë këtë raport, por kjo është lojë e juaja se as këtyre nuk keni me ua paguar.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: E para sa i përket vitit 2021 unë nuk kam qenë atëherë drejtor, po ashtu në atë kohë ka qenë një Rregullore tjetër në bazë të së cilës nuk është kërkuar edhe miratimi i raportit në Kuvend, për këtë arsye ne nuk e dimë se pse nuk janë paguar, nëse nuk janë paguar. Mirë e thae se ne i besojmë ati Komisioni sikurse edhe unë i besoj ati Komisioni dhe bazohem në të dhënat e ati Komisioni profesional që është zgjedhur besoj edhe ju pajtoheni. Komisioni e ka kry punën në teren sipas normativës në fuqi, tash po kërkohej nga viti kaluar edhe këtë vit që raporti të kalojë nëpër Kuvend. Dhe pastaj Raporti bashkë me vendimin e Kuvendit shkon në Qeveri, por jo Komuna të marr obligim për pagesën e mjeteve, se nuk ka mundësi. Unë vetëm po kërkoj që ky raport të votohet dhe të shkoj për pagesë, kurgjë tjetër, tani a paguhen dëmet apo jo kjo nuk varet nga ne. Në Qeveri është një Komision që e bëjnë vlerësimin e tyre, kështu që sipas vlerësimit të tyre janë bërë pagesa në vitin 2023.

z.Përparim Ramusa: Komisioni e ka bërë punën në mënyrë profesionale dhe nuk e kontesojmë ne punën e tyre. Por çështja që e ngrita unë është ju jeni bërë drejtor në vitin 2022, dëmet kanë ndodhur në vitin 2021, nuk mund të paguhen dëmet atëher kur kanë ndodhur. Dëmet nuk janë paguar të vitit 2021 dhe të vitit 2023, kaq. Sigurt që e votojmë propozimin dhe uroj që fermeret të paguhen për dëmet.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Unë e thash se në vitin 2023 ka ndryshuar procedura, dhe ka filluar të kërkohej që raporti të kalojë nëpër Kuvend, që dmth. Komisioni ka pas kompetencat me e bartë raportin direkt në nivelin qendror. Sa i përket pyetjes të Rrezarta Ramadanit, që është përmendur në raport dy herë i njëjti person tani unë nuk i kam të gjitha të dhënat për raportin, Kryetarja e Komisionit e ka një lëndim dhe nuk është present, por unë besoj se ka mundësi që personit të njëjt i janë shkaktuar në dy vende dëme ose në dy parcela. Kjo ka mundur të jetë.

z.Kadri Emini: Krejt u pajtuam që Komisioni është profesional, dhe normalisht që si grup parlamentar do të jemi "Për", megjithatë një rekomandim e kam drejtor sepse kemi informata dhe duhet ta dini që qytetast janë laik në kuptimin e shkrimit të ankesës ose kërkesës drejtuar Komunës, dhe e di që ju ballafaqoheni me lloj lloj kërkesa që nuk janë të harmonizuara me të drejtën që u takon, megjithatë është obligim ligjor që secilës kërkesë me i kthi përgjigje për miratim ose refuzimin e sajë. Kemi raste kur kërkesa e tij është refuzuar dhe nuk i është kthyer një përgjigje pales dhe ai pret edhe më tutje duke shpresuar për kompenzim.

z.Rexhep Gashi: E falënderoj drejtorin për elaborim edhe Komisionin për punën që e ka bërë, edhe parafolsit thanë se nuk kemi vërejtje dhe arsyeja është se janë munduar ta bëjnë punën më të mirë të mundshme. Unë uroj që kompenzimi dëmeve të bëhet e jo të mbetet vetëm në letër. Te shkelja e privatësisë për publikimin e emrave e thane edhe parafolsit unë mendoj se ju drejtor dihet me na argumentuar se pse është shkelje e privatësisë kur ju keni refuzuar kërkesat e atyre dhe i keni publikuar në Veb-faqen e Komunës, aty nuk ka qenë shkelje e privatisë e këtu te ne është shkelje e privatësisë. Sa i përket materialit mund të themi se edhe këtu është një material i mangësuar pak se pse mos me shkru këtu edhe se far dëmi u ka ndodhur atyre kjo për arsye që me i hjekë dilemat.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vetëm sa për sçarim, puna e Kuvendit është vetëm me ja dhënë dritën jeshile për me shku ky raport në Ministri, përpara Komisioni e ka dërguar direkt pa kaluar në Kuvend. Tash mendoj se nuk kemi nevojë që ta stërzgjatim.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Si përgjigje në pyetjen e Rexhës është se Komisioni e ka një shabllon ose mostër që u vjen nga Ministria e të cilën e përdorin edhe komunat tjera. Tash nëse është dikush i interesuar për me ditë për një lëndë të caktuar atëherë të gjitha lëndët e kompletuara janë te Komisioni. Këtu i kam listen e emrave që janë të refuzuar dhe unë u kërkoja mirkuptim nga ju për mos me nxit debat të pa nevojshëm sepse të gjitha i kanë përgjigjet e Komisionit bashkë me arsyetimin e tyre. Kërkoj që raporti të miratohet dhe të ecim tutje.

znj.Adelina Beqaj: Nuk po e kontestojmë punën e Komisionit, ne gjith e kemi vullnetin për me i dhënë dritën jeshile këtijë raporti, por qysh na i ke pru emrat e atyre që janë pranë po na intereson me ditë edhe për emrat e atyre se kush është refuzuar, për der isa ata e kanë bërë një

kërkesë dhe ata e kanë pas një arsye për me ba kërkesën. Po du me pa qatë listë dhe nuk po dua me publiku asgjë veq po du me i ditë emrat.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Pas seancës mund ti merrni e ti shihni pa asnjë problem, sepse këtu i kam.

z.Reshat Mujota: Tek jo temë realisht unë veq prita me votu këtë listë, por desha me ja ban je pyetje drejtorit lidhur me ate që tha për ministrinë se është një shabllon, e unë nuk e besoj që në ministri bëhen punët me shabllon por me ligj dhe rregullore, nëse mundesh me na thenë se cili shabllon i ka përcaktuar këto kritere? Ama një sqarim drejtor te kjo pikë, a të rrëshqiti rastësisht kjo apo është vërtetë me shabllon.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP: Po më duket se më shumë unë po keqinterpretohna se sa që po kuptohem, unë u lidha me atë qka e tha Rexha, unë thash se formatin e kësaj letre ku e ka emrin, mbiemrin, llogarinë e të dhëna tjera ky pra është vetëm një format i njejt të cilin Komisioni duhet me e plotësuar. Sa i përket vlerësimit ai bëhet bazuar në ligje dhe rregullore që janë në fuqi.

z.Besnik Seferi: U diskutu e u sterdiskutu, dhe në emër të grupit parlamentar po mendojmë që nuk pate nevojë për kaq shumë diskutime, sepse Komisioni e paska bërë punën e vet e ka bërë vlerësimin, e qytetarëve më shumë që u intereson me u dale këto mjete kurgjë tjetër, për qka uroj që ky vendim të jetë një fuqi shtesë për ta shty përpara procesin e ndarje së mjeteve për ta.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Raportin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësi tjera (FN&FT) në komunën e Shtimes për periudhën Janar-Dhjetor 2024, si vijon:

1. Dëmet e përgjithshme në Ekonomit Familjare	74,466.20 €
2. Dëmet e përgjithshme në sektorin e Bujqësis	12,402.05 €
3. Dëmet e përgjithshme në sektorin e Biznesit	6,441.40 €
TOTALI	93,309.65 €

Pika 4

Propozim-Vendim për Subvencionimin e Nënave Lehona të Komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtoreshës Mimoza Salihu-Qeriqi.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Përshëndetje. Siç jeni në dijeni vitin e kaluar është bërë vendimi me përshkallëzimin e pagesave për nënat lehona, njejt e kemi edhe këtë vit, mirëpo me propozim-vendim ne vetëm kemi kërkuar nga ju si Kuvendarë që ta votoni këtë vendim me vetëm disa ndryshime teknike që kanë të bëjnë me datat dhe vitet. Në KPF-ë është diskutuar dhe ka kaluar. Pra te ky propozim-vendim nuk kemi asnjë ndryshim tjetër përveq se propozimin që mos të përmendet në vendim viti për të cilin po miratohet. Ju ftoj që ta miratoni.

z.Përparim Ramusa: Faleminderit drejtoresh, si grup parlamentar i PDK-ë ne e përkrahim këtë propozim të DSHMS-së.

z.Besnik Seferi: Faleminderit drejtoresh, edhe ne në emër të grupit parlamentar të LVV-së e përkrahim këtë propozim i cili është shumë i mire dhe i qëlluar për gjithë qytetarët.

z.Muhamet Ademaj: Ne si grup parlamentar i LDK-AKR e përkrahim këtë vendim për subvencionimin e nënave lehona të komunës së Shtimes për ç'do fëmijë të lindur, me arsyetimin se i ndihmon ekonomikisht nënat lehona duke qenë një ndihmë simbolike. Shpenzimet janë të përballushme pa pas ndonjë ngarkesë financiare të buxhetit. Kërkojmë që vendimi të zbatohet sa më parë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për subvencionimin e Nënave Lehona të komunës së Shtimes, për çdo fëmijë të lindur.

Pika 5

Informatë e DBF-së për Raportin Periodik lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Më lejoni që përmes kësaj seance ta njoftoj Kuvendin për pasqyrat financiare lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm për vitin 2023. Pasqyrat financiare të vitit 2023 kanë pasur 8 rekomandime, faktikisht prej tyre 3 kanë qenë të reja dhe 5 të përsëritura, dhe nga këto 4 janë zbatuar, ndërsa edhe 4 tjera janë në proces. Sa i përket rekomandimit të parë, ky rekomandim është zbatu sa i përket pjesës të AKP-së që i kemi shly obligimet e komunës që i ka pas AKP-së në vlerë 46.000 euro. Sa i përket rekomandimit të dytë "Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve" kjo ka të bëjë me kontratën Kolektive e cila komunës tone pa dashje i ka bërë dëme të mdhaja, për arsye sepse njëra prej pikave që e ka qit raportin e "Kualifikuar" është edhe kjo. Pagesat janë kryer nga kategoritë tjera buxhetore pa vullnetin dhe miratimin tonë. Ky rekomandim është në proces. Rekomandimi i tretë është "Prezantimi jo i drejtë i detyrimeve kontigjente" edhe ky rekomandim është i zbatuar, vetëm që nuk janë ndarë detyrimet prej obligimeve kontigjente, vetëm ato që kanë qenë në procedure nuk janë nda, tash ky është rekomandim i përfunduar. Rekomandimi i katërt ka të bëjë me ndarjen e Subvencioneve dhe transfereve na e kemi diskutuar edhe në seancat tjera, ktu më shumë kanë qenë disa gabime teknike mirëpo ky rekomandim është i zbatuar. Rekomandimi i pestë "Mungesa e projektit ekzistues dhe mosvendosja e tyre në platformën e prokurimit" po ashtu ky rekomandim është i zbatuar sepse tani në bashkpunim me Auditorin kemi ardhur në përfundim se projekti mundet me u futë në platformë edhe pjes-pjes. Edhe ky rekomandim është i përmbyshur. Rekomandimi i gjashtë "Shkelje e kontratës nga ana e shfrytëzuesit të pronës komunale" ky rekomandim është në proces, një pjesë është përmbyshur por ka edhe një pjesë tjetër që duhet përmbyshur. Rekomandimi i shtatë "Rexhistri i kontratave përmes E-prokurimit" menaxherët e kontratave nuk është që nuk e kanë kryer punën e vet mirëpo e kanë kryer punën fizikisht e jo përmes platformës E-prokurimi. Ky rekomandim është në proces dhe kanë filluar menaxherët e kontratave me e përmbyshë këtë rekomandim. Rekomandimi i tetë "Efikasiteti i ulët në menaxhimi i llogarive të arkëtueshme" edhe ky rekomandim është në proces, e dime që te departamenti i tatimit në prone kemi prona në emër të serbëve ose prona te të cilat pronari ka vdekur ose diçka tjetër, kështu që edhe ky rekomandim është në proces sepse neve ligji nuk na e lejon për me i fshi obligimet tatimore të pronarëve që realisht është shumë vështirë të gjinden. Përpara ka qenë si kusht për ndonjë shërbim komunal pagesa e tatimit në prone dhe tash më nuk ekziston dhe është vështirë të përmbyshet ku rekomandim. Kjo është informatë dhe ju mirpres për fardo pyetje që keni.

znj.Adelina Beqaj: Faleminderit drejtor, raportin e auditorit e kemi diskutuar por po më intereson te kontrata kolektive ku thae se Përmbaruesi e ka bërë punën e vet në Komunën tonë, po më intereson me ditë sa ka shku vlera e kompenzimeve konkretisht sa pare janë marrë konkretisht prej Komunës tonë deri tani për kompenzimin e këtyre.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Ju i keni raportet për cilat kategori ekonomike se sa kanë qenë, diku mbi 800.000 euro është vlera dmth. që është e ekzekutuar e kësaj kontrate kolektive. Është fjala për vitin 2024. Por këto janë pasqyra të vitit 2023. Kështu që në këtë vit pritet me u bë rreth 1.5 milion euro për me u ekzekutu.

Pika 6

Propozim-Vendim për anulimin e Vendimit Npi-01/346 dt. 31.10.2024 për themelimin e vendgjuesisë të përbashkët në teritorin e komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike drejtorin Gojart Bajrami nuk e kemi prezent, tani sa më shkruajti se ka probleme shëndetësore dhe nuk po mund të jetë në vendin e tij të punës. KPF-ja e ka dhënë rekomandimin e vet për me kalu këtë pike, prandaj ne po e hapim diskutimin meqenëse materialin për këtë pike e keni marrë. Kjo pike realisht duhet të bie në pikën zero dhe në një seancë tjetër vjen si propozim ri për miratim, krejt kjo për shkak të

disa gabimeve në udhëzimin administrative dhe ligjit që kanë qenë të vitit 2009 nëse nuk gaboj. Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi: Drejtorit i uroj shërim sepse vërtetë është prezent një grip. Por mund të themi se neve na ka ardhur një material shumë i koklavitur. Arsyeja pse po na kthehen vendimet nga MAPL-ja, unë mendoj se këtu është se kur kemi pas thënë në një keqplanifikim, keqmenagjim, keqinterpretim ligjor ju thojshi qka është, për këtë arsye 12 mbledhje 10 vendime na janë kthyer në këtë vit. Është një mungesë e interpretimit ligjor. Çka jemi kah bëjmë këtu, n'akeni prezantu një document 2017, 2018, 2012 ku kanë qenë këto dokumenta të cilët drejtori ka ardhur e ka elaboru këtë punë dhe e ka pas edhe në dëgjim publik rreth çështjes të kti dhënjes për vendgjuesi dhe në kuvend na ka ardhur pas dëgjimit publik, i kemi shterrur të gjitha diskutimet dhe kemi disa here personalisht nga unë që kam ngritë shqetësim, drejtor qysh jeni me ligj, konform ligjit jemi. Tash po na del që nuk jemi konform ligjit. Kjo nuk është vetëm kjo drejtori por me të gjitha drejtoritë ktu, jinni tu i marrë do hapa shumë të shpejtë, pa interpretim ligjor, dhe neve çka po na ndodhë, po na ndodhë përveq se nga dy here tu i marrë këto vendime po dalim jo serioz në Kuvend edhe ndaj qytetarit edhe ndaj Ministrisë, po e kemi edhe një përgjegjësi publike, unë qysh në fillim thash si asambleist si drejtor si ekzekutiv çka do, ktu nuk është problem si jemi kah e fajsojmë njeni tjetrin, po jemi kah e fajsojmë atë smundjen e injorancës të cilën vetëm jeni tu punu ashtu pa interpretim ligjor, edhe ju mes veti, jo veq me legjislativin po edhe me ekzekutivin nuk jeni tu u konsulltu mes veti. E keni një zyre ligjore aty ju lutem që i merr nja njëmijë euro, përveq kësaj zyre Kryetari e din që e ka edhe një zyre ligjore të kontraktuar që merret me këto çështje, i keni 5-6 zyrtar ligjor që paguhet e kanë njëfar koeficienti koxha të mirë. Nu muajin e dhjetë e kemi marrë këtë vendim, në muajin shkurt na vjen me shfuqizim këtë vendim. Çdo vendim kur shfuqizohet i ka afatet ligjore, ju jini tu i kalu edhe afatet ligjore.

z.Reshat Mujota: Sa i përket Propozim-Vendimit për anulimin e Vendimit për themelimin e vendgjuesisë unë jamë "Për" sepse është edhe rekomandim nga Ministria. Kisha pas një lutje të sinqert, se edhe kur e kemi marrë këtë vendim, unë jam ai që e kamë kërkuar zyrtarin ligjor këtu, dhe e kamë ditë sigurtë që kjo ka me na u kthy prap. Kisha pas si kërkesë që nëse kjo vjen si pikë, të vjen edhe përfaqësuesi ligjor, se na këtu jurista nuk jemi, sepse vërtet mungesa e përfaqësuesit ligjor është duke na shkaktuar probleme, dhe arsyet pse nuk merr pjesë asnjëher nuk i kamë të qarta asnjëher.

z.Përparim Ramusa: Ashtu sikur e potencoi edhe parafolsi në emër të grupit parlamentar të PDK-së, çdo vendim i Kuvendit që është në kundërshtim me ligjin jemi për me korixhu. Sipas rekomandimit të Ministrisë së Bujqësisë ky vendim nuk është në përputhje me ligjin dhe ne jemi që ky vendim të anulohet.

z.Kadri Emini: Realisht nuk është mirë me i anulë vendimet por kjo është çështje ligjore që MAPL-ja i monitoron secilin vendim të Kuvendit, për shkak se anëtarët e Kuvendit dhe ekzekutivit nuk munden me qenë shumë profesional, për këtë arsye edhe ligji e ka paraparë një gjë të tillë të monitorimit të vendimeve të Kuvendit. Nuk është shumë tragjike për rastin konkret unë jamë në dijeni që edhe dikush prej zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë e ka rekomandu apo e ka udhëzuar drejtorinë e bujqësisë për me shku në këtë formë qyshë është shku, dhe masi është marrë vendimi është dalë se nuk është në harmoni me ligjin, kështu që nuk e shoh shumë tragjike sepse nuk është krijuar kurrfar pasoje juridike. Ka pasë edhe vendime të tjera të tilla dhe është plotësisht normale, ne duhet ta japim maksimumin secili anëtar i Kuvendit që para se me i votu pikat e rendit të ditës me u siguru se ato janë në harmoni të plotë me ligjin. Drejtoria zotohet se në të ardhmen në harmoni me Ministrinë ti vazhdoj hapat e mëtutjeshëm. E thanë grupet tjera parlamentare që janë "Për" edhe ne po deklarohejmë se jemi "Për" anulimin e këtij vendimi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit, prezentë.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi, Vendimin për Anulimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/346 të datës 31.10.2024 për caktimin e vendgjuesisë në territorin e komunës së Shtimes.

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Unë realisht kam një kërkesë që të bëhet dekorimi i sheshit për nder të muajit të shenjtë të Ramazanit. Pyetjen e dytë e kam për DSHP-në, ku jemi me kontratën për mirëmbajtjen e parqeve, dhe trotuareve në Komunën e Shtimes? Pyetje për DKA-në, si qëndrojnë punët e deritanishme të bëra nga Drejtoria e Arsimit, lidhur me çerdhen e fshatit Godanc, kur do të hapet Çerdhja? Pyetje për DSHP-në, kurë do të mbyllet gropat e hapura në rrugën “Çamëria”? Pyetje për DSHP-në, ku jemi me procesin e kontratës drejtor a janë të përfshira të gjitha fshatrat me kontratën e mirëmbajtjes së varrezave.

znj.Rrezartë Ramadani: Kamë këto pyetje: Pyetje për DSHMS-ë, Sa fëmijë janë vaksionuar, dhe a ka pas ndonjë prej tyre që ka refuzuar të vaksionohet?

z.Reshat Mujota: Kamë këto pyetje: Prej Urbanizmit nuk kam marr asnjë përgjigje veq prej DSHP që ka thënë do të intervenojmë e u bënë 6 muaj e nuk ka intervenim për sanimin e dëmit. Pyetjet e njejta për DPUKGJ kisha pas qef me më dhënë përgjigje të drejtpërdrejt, dhe pse nuk mu ke përgjigj a e ke lënë me mu përgjigje tash me gojë apo si. Dhe e kam nje pyetje shtes përveq atyre që i kam bërë. Pyetje për DPUKGJ-në, për pjesën e trotuarit ne Mollopolc te pjesa e murit që ka mbetur pa u vazhduar a është ndërmarrë diçka te ajo pjes, cilat janë planet, kërkoj nje përgjigje konkrete, drejtpërdrejt? Pyetje për DPUKGJ-në, në fshatin Carralevë te lagja Balaj, me rreth 30 shtëpi me një rrugë shumë të ngushtë është kërkuar që rruga e tyre të zgjerohet, dhe të shtrohet me asfalt, nuk e kanë të zgjidhur çështjen e kanalizimit në atë lagje si dhe kërkojnë me e funksionalizuar ndriçimin publik?

Pyetje për DPUKGJ-në, pyetja tjetër është për Trotuarin prej Hallës Sportive deri te Çeshmja e Mujotëve. Ky ka qenë projekt që e kemi votuar dhe i buxhetuar, pse nuk ka vazhduar ky realizim, a nuk ka mjete a si është puna? Pyetje për DPUKGJ-në, edhe për sa i përket ndriçimit në fshatin Belinc mundësisht me u specifikuar koha, procedura për me ditë përafërsisht se në cilën kohë fillojnë punimet? Pyetje shtesë për DPUKGJ-në, ka kërkesë nga banorët e lagjes “Neziraj” që ta kanë një pjesë për ndërtimin e një Salloni për të pame, kisha pas qef me marrë një përgjigje nga ju për me ua dhënë një përgjigje konkrete banorëve?

znj.Adalina Beqaj: Kamë këto pyetje: Pyetje për DKA-në, çka ka ndodhur në shkollën e fshatit Petrovë pse po mbahen vetem ka dy orë mësim në ndrrime të ndryshme? Pyetje për DSHP-në, çka ka ndodhë me trotuarin në fshatin Petrovë, në pjesën qendrore e kam fjalën sepse e di që nuk ka përfunduar? Pyetje për DSHP-në, çka ka ndodhë me sallonin e të pames, cili është vendimi i Gjykatës, dhe çka keni ndërmarrë ju si drejtori për këtë rast? Pyetje për DPUKGJ-ë, edhe një kërkesë e keni nga banorët e lagjes “Gjyteti” për rregullimin e shtratit të Lumit, edhe një pjesë e trotuarit pasi që frekuentohet ajo rrugë shumë? Edhe po më intereson me ditë te rruga “Skender Salihaj” ku jeni munduar pak ta rregulloni aty ku qëndron hekuri se ka pas edhe gropa mirëpo nuk është sanuar në mënyrën e duhur kjo rrugë dhe kërkoj nga ana e juaj që të ndërmerrni hapa konkret edhe të dilni e të shihni se në qfar gjendje është punu?

z.Rexhep Gashi: Kamë këto pyetje: Pyetje për DPUKGJ-ë, drejtor a ka në listen e projekteve të cilët kanë qenë projekte 2023-2024 dmth. një kontratë dy vjeqare, do të thot është punuar ajo rrugë në fazën e parë të zhavorit, nuk është punu me asfalt, dhe ju ka ndërpre puna, pse është ndërpre puna në ato rrugë? Unë e di që ka, edhe i bëj edhe publike se ju e dini që unë nuk e kam atë far telashe hiq, edhe ju drejtor a ka familje, unë sjam kundra atyre familjeve, të cilëve u shtrohet asfalti mund të them edhe mbrenda rrethojës së oborrit, ndërsa Lëvizja për Bashkim, dhe VV-ja ka qenë shumë e zëshëm atëherë, nuk qenkan këtu se i kam pas disa asambleista në LB i kam fotot: (komunikim interaktiv i z.Rexhep Gashit me z.Besnik Seferin), (Kryesuesi, te lutem zotri Gashi vazhdo me pyetjet, prap o te lutem vazhdo me pyetjet).

Pyetje për DPUKGJ-ë, ju lutem drejtor edhe nje pyetje du me ba të thjeshtë, a ka projekte, konkretisht drejtorisë së juaj, të cilët operatorët punojnë pa kanë në listen e projekteve?

z.Muhamet Ademaj: Kamë këto pyetje: Pyetje për DBPZHR-ë, dua ta di se kush janë përfituesit e Kultivatorëve në komunën e Shtimes? Pyetje për DSHP-në, pyetja e dytë është kur

pritet largimi i deponive ilegale në afërsi të Palestrës Sportive, drejtor edhe pse aty është edhe tabela që shkruan për mosëdhjen e mbeturinave mirëpo qytetarët vazhdimisht hedhin mbeturina dhe është bërë një deponi koxha e madhe, është propozim i imi që aty të vendoset një kamerë ndoshta do të ndikojë pozitivisht në parandalimin e hedhjes së mbeturinave të ngurta në atë vend? Pyetje për DPUKGJ-ë, që nga viti 2021 ka filluar projekti trotuarit në rrugën "Skender Salihaj" dhe "Hyre Emini" a pritet që të realizohet sivjet ky projekt?

znj. Albana Podvorica: Kamë këto pyetje: Pyetje për DPUKGJ-ë, kurë do të bëhet ndriçimi në rrugën "Lutfi Bilalli" dhe për trotuarin drejtor, kur do të bëhet shtrimi i trotuarit në rrugën "Skender Salihaj" që nxënësat dhe mësime të përballesh me atë pjesë? Pyetje për DSHP-në, drejtori është zotë që do të verifikoj dëmet e trotuareve në rrugën "Anton Çeta" kërkoj që të identifikoj dëmet në trotuarin e kësaj rruge dhe sipas nevojës duhet të ketë edhe ndërhyrje, prandaj më lejoni të ju pyes kur do të bëhet ky verifikim i dëmeve të trotuarit, nëse jo kur do të bëhet? Pyetja tjetër është për Kryetarin, edhe për DSHMS-në, kurë planifikohet që organizatës "Handikos" ti ofrohet hapësirë publike në mënyrë që ajo ti plotësojë të gjitha kushtet për veprimtarinë e sajë, apo ti ndërtohet një objekt sikurse kanë vepruar disa komuna tjera në bashkëpunim me organizata apo donator?

Pyetja tjetër në fakt është rekomandim, dhe kjo është për drejtorinë e Arsimit, lidhur me fushatën vetëdijësuese që organizohet nëpër shkollë nga Policia e Kosovës në Shtime, ju rekomandoj që ta rrisni numrin e nxënësve përfitues duke përfshirë minimalisht të gjitha klasat e nënta jo vetëm në Shtime por edhe në paralelet e ndara, dhe pse jo të shikohet mundësia edhe të klasat e tjera.

znj. Zejnije Veliu: Kamë këtë pyetje: Pyetje për DSHP-në, është një qytetarë nga fshati Reçak që po bëhet fjalë për rrugën "Qorr Ilazi" në Reçak, është një segment rrugor ku disa drunjë paraqesin pengesë në atë rrugë, drunjët janë në pronë private, qytetari bën pyetje a mundet drejtoria me ndikuar te qytetari si pronar i atyre drujve që ti largon nga rruga a mundet me bërë diçka?

z. Asllan Beqaj: Kamë këto pyetje: Pyetje për DSHP-në, siç jeni në dijeni ndoshta se KEDS ka filluar ndërrimin e disa shtyllave në Petrovë, dhe dritat e ndriçimit kanë mbetur në shtyllat e vjetra, a keni ndërmarrë ndonjë hap për me i ndërruar këto drita në shtyllat e reja? Pyetje për DSHP-në, pyetja ka të bëjë me fazën e katërt të trotuarit në Petrovë që është përfunduar trotuari por ndriçimi ende nuk është përfunduar, a ka me fillu brenda këtij viti me u krye edhe ndriçimi?

z. Gzim Haxhiu: Kamë një kërkesë për drejtorinë e Arsimit e cila ka të bëjë me renovimin e shkollës të fshatit Rashinc. Pyetje për DSHP-në, kërkesë për rregullimin e ndriçimit në rrugën "Dragusha" dhe "Taravillazi" në Godanc të poshtëm.

Përgjigje: z. Grejtalb Emini, DPUKGJ – Përsëritje. Sa i përket pyetjes së Reshatit, të gjithë e dime që kur bëhet paramasa e ka një vlerë të caktuar nga buxheti dhe varësisht nga vlera janë punuar projektet edhe në fshatin Mollopolc. E di që titullin e projektit e kemi pas nga salla sportive deri te salloni i të pameve mirëpo, është kryer vetëm një pjesë e trotuarit, është kryer pjesa e ndriçimit komplet nga fillimi deri në fund, ajo pjesë e trotuarit që ka mbetur po shpresoj që në vitet në vazhdim kemi me e përfunduar por ka pas edhe prioritete të tjera Brenda fshatit Mollopolc siç e din që kanë qenë më të rëndësishme se sa trotuari prej qeshmes deri në fshatin Mollopolc. Sa i përket lagjes Balaj, rrugën edhe kanalizimin e kemi diskutuar me banorët e lagjes Balaj kam qenë në takim me ta dhe kemi dakorduar me ta që gjitha ato pjesë. Pyetja për sallonin e të pames në Mollopolc, sa kam unë informacione aj salonin i të pames është në zonën ku prona është e pylltarisë, nuk është prone komunale. Ne me sallone të pameve po kemi problem edhe aty ku po janë prona komunale. Unë i sygjeroj banorët që me ba kërkesë në Komunë, dhe Komuna e lëshon një pëlqim që nuk ka interes në atë prone të pylltarisë dhe tash sa e di unë tash në këtë moment ka një konflikt mes ligjeve të pronës publike dhe të ligjit të pyjeve, nuk ka mundësi me marrë kontratë me Pylltarinë mirëpo besoj që në vazhdim zgjidhet ajo dhe një përfaqësues i lagjes e marrin kontratën e Pylltarisë dhe e ndërtojnë sallonin e të pames në pronën e Pylltarisë. Ne si Komunë nuk kemi ndonjë problem për me u ndërtuar ai salloni aty, nëse pra Komuna nuk ka interes në atë zonë. Sa i përket trotuareve në fshatin Petrovë e përmendi

edhe Asllani që një pjesë e trotuarit në rrugën kryesore të Petrovës ka përfunduar faza e katërt por pritet tash në vazhdim edhe ndriçimi me përfunduar. Është në kontratë një trotuar në lagjen "Hysenaj" diku 450 metra që fillon tash së shpejti si të rregullohet moti. Në secilën pjesë në fshatin Petrovë ku ka nevojë për trotuar besoj që e kemi tash më prioritet se e kemi pa që ka edhe problemet he pengesa në rrugë në shumicën e çasjes në Petrovë, në momentin që kryhen krejt trotualet edhe pengesat në rrugë kemi me i larguar sepse është një problem shumë i madhë në atë zonë. Sa i përket shtratit të Lumit, të gjithë e dinë që Komuna ka përfitu në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ku pas kërkesës së Kryetarit 1.8 milion janë të buxhetuara për rregullimin e shtratit të Lumit në fshatin Petrovë, ku përfshihet edhe fshati Reçak dhe Belinc. Te pjesa e pyties së Rexhes, i ka pytet shumë interesante, a ka rrugë me dy faza, sigurisht që ka, buxhetin komunal e kemi pak më të vogël se buxheti i Qeverisë edhe nuk ka mundësi Komuna me i kry rrugët me një fazë komplet, ka mundësi që pjesa e zhavorit kryhet këtë vit e pjesa e asfaltimit në vitin tjetër, konkretisht në fshatin Gjyrvokv kemi këso raste ku pjesa e zhavorimit ka përfunduar në vitin 2024 e tash në 2025 fillon pjesa e asfaltimit. Në kushte normale është mire për asfaltim nëse rruga pushon një vjet ose disa muaj nëse hyjmë në dimër, por ne kemi qef me i kry punët shumë shpejt dhe kërkesat e banorëve janë krejtësisht legjitime. Sa i përket projekteve sa a ka projekte a ska projekte, unë e kam obligim me zbatu një projekt që është i shkruar i vizatim dhe që e ka një paramas që e ka ajo kontratë. Çka ka jashtë këtyre nuk janë pyetje për mu. Kontraktimi i dikujt të ndonjë kompanie privatisht ajo pjesë mua nuk më intereson. Në kushtet që i thash për zbatimin e kontratave mund të diskutojmë derën çel e ke. Sa i përket rrugëve private, duhet me diskutu edhe një here qartë, çështja e pronësisë së rrugëve në Komunën e Shtimes është e pa zgjedhur jo veq në një fshat por në të gjitha fshatrat. Lagje të tëra që kanë rrugë me ka 200-300 metra që janë të pa definime sa i përket parcelës. Ne si Komunë kemi kërkesa prej atyre banorëve, ata janë taksapagues tonë edhe kanë dëshirë me ju shtru rruga asfalt, mirëpo qështjen e pronësisë e kanë të pa zgjidhur. Ne si ekzekutiv jut hemi të gjithë banorëve e bëjnë një kërkesë te Noteri që nuk duan kompenzim prej Komunës, nëse nuk munden me zgjedhë çështjen e pronësisë. Ligjore është me u skicu, por kur nuk ka mundësi ligjore kjo është kërkesa jonë e vetme, edhe shtrohet ajo pjesë që realisht duket private por që shfrytëzohet prej 10-15 shtëpive në atë lagje. Ka disa raste të tilla, prandaj mos të mendohet se dikujt po i shtrohet oborri, se nuk është e vërtetë. Edhe një çështje tjetër kur shkon kompanija me shtru te një lagje e caktuar një pjesë të caktuar ka mundësi që banorët me u grumbullu aty dhe me e shtru një pjesë të caktuar të asaj lagje, që nuk është prej Komunës, kemi raste në Petrovë ke edhe në Gjyrvokv që e shtron para shtëpisë së vet me asfalt për shkak se Kompania vjen një her në pesë vjet aty. Sa i përket pyetjes së Albanës në kordinim me drejtorinë për shërbime publike është duke u punuar kontrata e ndriçimit publik edhe besoj që kena me dalë me pa atë pjesë, edhe përfundimisht trotuari në rrugën "Skender Salihaj" ka me u përfunduar, se është shumë pjesë e vogël. I mbeta borgj Reshatit për fshatin Mollopolc, është e vërtetë që e kemi nisë një trotuar prej Xhamisë deri te sheshi i Flamurit, ku një pjesë e këtij trotuari ka përfunduar, edhe një pjesë fillon shumë shpejt me u përfunduar, e kemi një problem te muri mbrojtës diku 150 metra ku paraqet kosto shtesë, dhe jemi në diskutim me kompaninë sa e implikon kontratën ajo kosto shtesë nëse na përkrahë kontrata unë besoj që kemi me e përfunduar. Në kushte normale pa u vendos aj muri, rrezikohet pak edhe shembja e dheut, nuk e di gjendjen qysh është ma nalt pjesa e dheut por në kordinim me banorët edhe me ty në këtë rast mundemi me dalë bashkërisht edhe me bërë një zgjidhje. Sa i përket trotuarit te çeshmja, Adelinë besoj se aty duhet me rregullu çështjen e ujit atmosferik që vjen prej kodrës, e kemi një telashe pak ma e theksime është, jemi tu punu në këtë drejtim edhe besoj shumë shpejt kemi me i dhënë përgjigje për me bashku trotuarin ekzistues deri te çeshmja. Sa i përket rrugëve që po e potencon Rexha, rrugët në Godanc ose në Gjyrvokv, ato rrugë Rexhë, unë ta garantoj që janë rrugë dy vjeqare, ajnë të bëra me zhavor në vitin 2024 periudha mundet me qenë Qershor-Korrik-Gusht, më the që janë bërë një vjet, e unë ta garantoj që një vjet nuk i ka, e kemi diskutu bashkarisht në zyre dhe e di saktë ku është ajo pjesë, nuk është një rrugë janë dy rrugë aty dhe janë katër rrugë naltë te lagja e "Cenve" që janë në të njëjtën kontratë me u kry. Sa i përket

rrugës “Mehdi Korrani” unë i kam vizitu atë, rruga ka filluar besoj që një vjet zhavorimi i sajë. Janë bërë matjet shtresa e parë është vendosur në kohën jo të mirë të motit, për shkak të ftohtit asfalti ka dështu në disa pjesë, na kemi diskutu me kompaninë, dhe kjo do të merr masa shumë shpejt dhe do ti largon ato pjesë të asfaltit. Pjesa e parë i ka dikund 6-7 cm. ndërsa pjesa e dytë i ka edhe 4-5 cm. që është pjesë më e hollë dhe besoj që shumë shpejt përfundohet. Ka punë të shaktet (pusetat) kur kryhet kjo pjesë vazhdon pastaj me pjesën tjetër të rrugëve. Sa i përket menagjerave të kontratave Komuna e Shtimes, fatkeqsisht i ka vetëm 2-3 inxhinjer, edhe nuk është e vërtetë që një menagjer i kontratës i ka gjithë ato kontrata. Janë të shpërndamë në shumë drejtori menaxhimi i kontratave. Flas me kompetencë se për rrugë janë 4-5 menagjer që i mbikqyrin kontratat e rrugëve. Komuna e Shtimes i ka vetëm dy inxhinjer në fakt i ka vetëm dy arkitekt momentalisht të punësuar këtu që është e pa mundur me vllimin e punëve që e kanë ditore këta dy persona me e kry edhe menagjimin e kontratave, edhe pse njëri prej tyre ka edhe menagjim të kontratave që sigurisht i ka 13-14 kontrata që i menagjon, edhe njëkohsisht i kryen edhe punët tjera brenda zyrës. Po besoj që këtë vit kemi me shpall konkurs dhe me fuqizu zyrën e Urbanizmit sepse shumica e kontratave në Kapitale dalin nga kjo zyrë. Sa i përket trotuarit në rrugën “Skender Salihaj” dhe “Hyrë Emini” kemi bërë kërkesë tash së fundmi për trotuarin te rruga “Hyrë Emini” për trotuarin që shkon deri te lagja e “Tërshanëve” po shpresojmë që kena me pas mundësinë që në paramasë me futë në rrugët ose të Petrovës ose të Mollopolcit po aty duhet me i bashku te dyjat sepse gravitojnë të dy fshatrat.

Përgjigje: znj. Mimoza Salihu-Qeriqi, DSHMS – Përsëhendetje. Sa i përket pyetjes së znj.Rrezartë Ramadanit për vaksionimin, realisht unë e kam përcjellë procesin e vaksionimit në komunën e Shtimes, në klasët e 12-ta janë vaksionuar 170 nxënës, ndërsa sa i përket klasëve të 6-ta ende është në process, shumica e nxënësve janë vaksionuar. Komuna e Shtimes dmth. Në të gjitha shkollat janë vaksionuar në total rreth 350 nxënës. Ndërsa sa i përket pyetjes të Albana Podvorica, për hapsir publike për “Handikosin” ose një ndërtim të një objekti të ri, ne jemi në kontakt me donatorë të ndryshëm për ndërtimin e një objekti të ri për “Handikosin” mirëpo konkretisht nuk kemi diçka për këtë.

Përgjigje: z.Bardhyl Rushiti, DSHP – Përsëhendetje. Sa i përket pyetjes së parë të Besnikut, për dekorimin e sheshit të qytetit për muajin e madhërishëm të Ramazanit. Besnik na e kemi menduar këtë far pjese për me bërë dekorimin e sheshit, por ne do ta shikojmë tash si do ta bëjmë dhe si do ta kemi mundësinë për me bërë. Sa i përket Kontratës të mirëmbajtjes, është nënshkruar dhe jemi duke vepruar në teren kryesisht sipas kërkesave që i kemi nga qytetarët dhe disa prishjeve që i kemi dhe tani do të vazhdojmë duke i rregullu. Edhe gropat në rrugën “Çamëria” që i ke përmend, besoj që kur të ngriten temperaturat, dhe fillojnë edhe kompanitë e asfaltit me i bërë një gjë të tillë edhe për këto do të kujdesemi. Sa i përket mirëmbajtjes së Varrezave, edhe këtë vit e kemi menduar se do ta bëjmë një gjë të tillë, që nuk ka ndodhur asnjëherë në komunën e Shtimes e që për herë të parë që po bëhet, që në vitin e kaluar dhe do të bëhet e njëjta edhe këtë vit. Do ti shikojmë edhe disa që nuk i kemi, dhe besoj se tash do ti kryejmë të gjitha në komunën e Shtimes. Sa i përket pyetjes për rrugën “Qorr Ilazi” i ka disa probleme që i di unë. Deponia ilegale është fakt profë që po na shqetëson të gjithëve, njëher po e analizojmë për me i largu mbeturinat e pastaj ta analizojmë edhe vendosjen e ndonjë kamere, së bashku me Policinë që e kemi këtu në Shtime, dhe Inspektoriatin. Sa i përket pyetjes së Gëzimut për ndriçimin në Godanc, edhe kjo besoj që do të ndodhë, këto qka na kanë mbetur disa rrugë apo rrugica do ti përfundojmë. Në Mollopolc te pyetja e Reshatit, kanë qenë kompania dhe kamë mendu që e kanë rregullu deri tash por nuk e paskan rregullu, besoj se nesër më së largu Reshat rregullohet ajo punë. Te pyetja e asambleistit Asllani lidhur me ndriçimin, edhe kta e kemi analizu Asllan dhe do ta shikojmë mundësinë se si me i vendos në shtyllat e reja. Në trotuarin në rrugën “Anton Çeta” kemi dalë dhe i kemi evituar ato probleme, besoj që aty ku janë disa probleme që mendojmë ne do ti eliminojmë dhe do të vazhdojmë tutje.

Përgjigje: znj.Yllkë Fejzullahu, DKA – Përsëhendetje. Sa i përket pyetjes së parë të zotri Seferi në lidhje me Çerdhen në Godanc të poshtëm është në ndërtim e sipër. Puna e vrazhdë është

kryer duke u bërë lyryja e objektit e rregullimi i oborrit, po konsideroj se në muajin Shtator ndoshta do të arrijmë që ta funksionalizojmë dhe ta hapim sin në objekt tjetër i ri i Çerdhes. Sa i përket pyetjes të zonjës Beqaj për mësim me orar të shkurtuar në Petrovë është e vërtetë që mësimi po mbahet me orarë të shkurtuar por nuk kemi pas zgjidhje tjetër. Aktualisht janë disa ndrrime që është duke u mbajtur mësimi kështu që ne po insistojmë që me rregullimin e motit ndoshta mësimin ta mbajmë pak më gjatë. E di që aktualisht do të ketë humbje të mësimi, kërë e kemi diskutuar edhe me drejtorin dhe kemi bërë kërkesë që këto orë të humbura të kompenzohen me ditët e shtunde. Duhet ta kemi parasysh dhe ti gëzohemi faktit se po na vjen një investim prej 1.4 milion euro për ndërtimin e Aneksit të shkollës, ndërtimin e Sallës të Edukatës Fizike, pastaj rregullimin e Oborrit dhe Fushës sportive që do të bëhet në këtë shkollë, që realisht është investim jashtëzakonisht i madh kështu që fokusi duhet të jetë te ky investim kaq i lartë që po bëhet, pa e minimize natyrisht rendësinë e mësimi, por në bashkëpunim edhe me prindërit do mundohemi të gjejmë forma që të mos ketë humbje të mësimi. Sa i përket pyetjes të zonjës Podvorica, konsideroj se përgjigjen që ja kam dhënë me shkrim ka qenë mjaft e qartë, dhe nuk po i përsëris të njejtat, e përmende që ka pas probleme me ngrohjen në shkollën "Emin Duraku" me sa di në të dyja shkollat se edhe unë aty kam thenë se për cilën shkollë "Emin Duraku" e keni fjalën. Te shkolla "Emin Duraku" lartë ka pas ankesa dhe kam shkruar vetë dhe e kam vërtetuar se objekti ka qenë i ngrohtë, unë kam hyrë edhe nëpër klasë dhe i kam pa nxënësit që nuk kanë qenë as me jakne realisht, që i bie se ambijentet janë të ngrohta. Sa i përket shkollës "Emin Duraku" poshtë ndoshta mund të ketë probleme me ngrohje, pasi janë kthyer pas pushimit dimëror që ka zgjat dy javë. Kështu që meqenëse objekti është jashtëzakonisht i madh dhe i duhet pak kohë deri sa të normalizohet. Përndryshe nuk ka pas ndonjë problem të theksuar. E kam theksuar se aty do të investohet sipas projektit të eficiencës së energjisë ku aty do të rinovohen paisjet e ngrohjes kalldaja pastaj ndërimi i dyerve dhe dritareve, dhe përfundimisht "Emin Duraku" do të rregullohet dhe nuk do të ketë problem me ngrohje siç ka pasur deri tani, kështu që quditërisht pushteti i kaluar nuk ka investuar asnjëher sepse këto problemet me ngrohje janë të kahmotshme dhe ndodhin me vite, e nuk është se po ndodhin tani për tani. Prat anë po investohet dhe kjo është lajm i mirë. Për rekomandimin që e dha zonja Podvorica lidhur me fushatën vetëdijësuese që organizohet nëpër shkolla nga Policia e Kosovës në Shtime, e konsideroj me vend dhe do ta kem parasysh. Zotëri Haxhiu pyeti për renovimin e shkollës në Rashincë. Zotëri Haxhiu ti si anëtarë i Kuvendit po besoj se e ke shikuar Buxhetin për vitin 2025 të Komunës së Shtimes ku në Buxhet figuron edhe shkolla "Lasgush Poradeci" që e përfshinë edhe paralelen e ndarë në Rashincë e cila do të rinovohet këtë vit. Aktualisht i kemi në dispozicion 170.000 euro për renovimin e shkollave, dhe këtu hyn edhe shkolla e Rashincës që realisht ka nevojë. Po ashtu edhe kërkesën e mëhershme e kemi plotësuar për çështjen e inventarit që ka pas shumë pyetje por që tash më nuk po e përmend, po ashtu është edhe salla e Edukatës Fizike.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora: 13:05h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi




Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

